

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8297  
E premte, 8 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

OVLUÇK-ja u dërgon  
letër ambasadave pas  
shtyrjes së aktgjykimit  
nga Specialja | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PALATOVA: KOSOVA DUHET T'I BINDË 27 SHTETET ANËTARE PËR STATUSIN E KANDIDATIT NË BE | FAQE 4-5



Ushtruesja e detyrës së sheshe  
së Zyrës së BE-së në Kosovë,  
Eva Palatova, ka thënë se  
Kosova nuk mund ta marrë  
automatikisht statusin e  
kandidatit për anëtarësim në

Bashkimin Evropian, duke  
theksuar se vendi duhet t'i  
bindë të 27 shtetet anëtare të  
BE-së. Në kuadër të shënimit  
të Ditës së Evropës, më 9 maj,  
në një organizim të Zyrës së

BE-së në Kosovë, ajo ka  
potencuar se Brukseli pret nga  
Kosova zgjedhje të lira dhe të  
drejta, formim të shpejtë të  
institucioneve dhe avancim të  
reformave

### AKTUALE



IRANI E SHOYRTON PROPOZIMIN  
AMERIKAN MES OPTIMIZMIT DHE  
KËRCËNIMEVE NGA TRUMPI | F. 2

PËRKUJTOHET HEROI BAHRI  
FAZLIU, NJË NDËR FIGURAT MË  
TË NDRITURA TË LËVIZJES  
KOMBËTARE PËR ÇLIRIMIN E  
KOSOVËS | F. 6

U.D. PRESIDENTJA HAXHIU  
DEKORON PAS VDEKJES REXHEP  
QOSJEN ME TITULLIN "NDERI I  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS" | F. 3

### EKONOMI



AKB-ja: DUKE NDËSHKUAR  
SHOIPËRINË NUK MBROHET  
TREGU VENDOR! | F. 8

BOK-JA PËRFSHIN ARIN NË  
PORTOFOLIN E REZERVAVE PËR  
HERË TË PARË | F. 8

### SPORT



BESIM ALITI EMËROHET  
KRYESUES I KOMISIONIT  
KOORDINUES PËR FESTIVALIN  
OLIMPIK EVROPIAN | F. 11



KURTI: S'KEMI  
SITUATË TË RE, POR  
ZGJEDHJE PËR TA  
PËRSËRITUR E  
TEJKALUAR REZULTATIN  
E 28 DHJETORIT | F. 5



RRYMA NUK U  
SHTRENJTUA SIVJET  
- POR ÇKA FSHIHET  
PAS KËSAJ? | F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# IRANI E SHQYRTON PROPOZIMIN AMERIKAN MES OPTIMIZMIT DHE KËRCËNIMEVE NGA TRUMPI

TEHRAN, 7 MAJ - Irani ka thënë të enjten se po e shqyrton propozimin më të fundit të Shteteve të Bashkuara, për të cilin burimet thonë se do t'i jepte fund luftimeve, por do të linte të hapura disa çështje kyç. Ndërkohë, presidenti amerikan, Donald Trump, ka theksuar se është "shumë e mundshme" të arrihet marrëveshje, por paralajmëroi gjithashtu se luftimet do të rifillojnë, nëse Teherani do ta hedhë poshtë marrëveshjen.

Agjencia shtetërore iraniane e lajmeve, ISNA citoi një zëdhënës të Ministrisë së Jashtme të ketë thënë se Teherani e kishte marrë propozimin amerikan dhe tani po i shqyrton hollësisht, megjithëse ai la të kuptohej se kishte dispozita të papranueshme për udhëheqësit e republikës islamike.

Propozimi amerikan për t'i dhënë fund luftës është ende "nën shqyrtim", citohet të ketë thënë Esmail Baqaei. Ai shtoi se Teherani do t'ia përcjellë përgjigjen ndërmjetësit, Pakistanit, pasi të "marrë një qëndrim përfundimtar".

Megjithatë, Trump tha se bisedimet e ndërmjetësuar nga Pakistani po shkojnë mirë. "Ata duan të arrijnë marrëveshje. Kemi pasur bisedime shumë të mira gjatë 24 orëve të fundit dhe

është shumë e mundshme që ta arrijmë një marrëveshje", u tha Trump gazetarëve në Zyrën Ovale të mërkurën vonë.

Më vonë, në një video mesazh drejtuar një tubimi të Partisë Republikane në Xhorxhia, Trump deklaroi se lufta "do të përfundojë shpejt".

Me këto deklarata ai shprehu një ton më optimist pas një postimi në rrjetet sociale më herët gjatë ditës, në të cilin Trump kërcënoi me rifillimin e fushatës amerikane të bombardimeve kundër Iranit dhe e quajti "supozim të madh" mundësinë që Teherani të pranojë propozimin amerikan.

SHBA-ja dhe Irani vazhdojnë të ketë mospajtime të mëdha për një sërë çështjesh, përfshirë aftësinë e Iranit për të pasuruar uranium dhe kontrollin e tij mbi Ngushticën e Hormuzit, rrugën jetike ujore përmes së cilës kalonte rreth 20 për qind e furnizimit botëror me naftë dhe gaz para luftës, e cila shpërtheu më 28 shkurt.

## Memorandumi njëfaqësh

Reuters citoi një burim pakistanez dhe një person tjetër të informuar për çështjen, të cilët thanë se palët janë afër marrëveshjes për një



memorandum njëfaqësh që do t'i jepte zyrtarisht fund konfliktit. Sipas burimeve të Reuters, më pas do të zhvilloheshin bisedime për zhbllokimin e transportit detar përmes ngushticës, heqjen e sanksioneve të mëdha amerikane ndaj Teheranit dhe vendosjen e kufizimeve për programin bërthamor të Iranit. Teherani ka këmbëngulur gjithmonë se programi i tij bërthamor është vetëm për qëllime civile, ndërsa SHBA-ja, Izraeli dhe vende të tjera perëndimore e kanë akuzuar se po bën përpjekje për ta zhvilluar ndonjë bombë bërthamore.

Agjencia gjysmëzyrtare iraniane e lajmeve, Tasnim shkroi duke cituar një burim anonim se propozimi amerikan përmbante disa dispozita të papranueshme, megjithëse nuk tregoi se cilat ishin ato.

Ligjvënësi iranian Ebrahim Rezaei, i cili shërben gjithashtu si zëdhënës i Komisionit Parlamentar iranian për politikë të jashtme dhe siguri kombëtare, tha se një version i mëparshëm i propozimit amerikan ishte "më shumë listë dëshirash amerikane sesa realitet". "Amerikanët nuk do ta fitojnë në një luftë që po e humbasin atë që nuk e kanë

fituar në bisedimet ballë për ballë", shkroi ai në rrjetet sociale. Reuters citoi një burim të ketë thënë se ekipi negociator amerikan po udhëhiqet nga i dërguari i Trumpit, Steve Witkoff, dhe dhëndri i tij, Jared Kushner.

Nëse memorandumi i tanishëm njëfaqësh pranohet nga të dyja palët, atëherë do të nisnin bisedime të hollësishtme njëmuajore për të arritur një marrëveshje të plotë, tha burimi. Një marrëveshje e plotë do t'u jepte fund bllokadave amerikane dhe iraniane në ngushticë, do të hiqte sanksionet amerikane dhe do t'i zhbllokonte fondet e ngrira iraniane. Ajo gjithashtu do të përfshinte disa kufizime për programin bërthamor iranian, me synimin për një pauzë ose moratorium mbi pasurimin e uraniumit, shtoi burimi.

Ndërkohë, Presidenca franceze tha se po dërgonte aeroplanmbajtësen Charles de Gaulle në pjesën jugore të Detit të Kuq për t'u pozicionuar paraprakisht për një mision të mundshëm për rikthimin e lundrimit në Ngushticën e Hormuzit.

Misioni i saj dërgon "sinjal se ne jo vetëm që jemi të gatshëm ta sigurojmë Ngushticën e Hormuzit, por jemi edhe në gjendje ta bëjmë këtë", tha Presidenca franceze.

# GJERMANIA BËN THIRRJE PËR T'I DHËNË FUND RREGULLIT TË UNANIMITETIT TË BE-së PËR TË NDALUAR 'NGËRÇIN' E VENDIMMARRJES

BERLIN, 7 MAJ - Gjatë një fjalimi në Berlin, ministri i Jashtëm gjerman Johann Wadepuhl bëri thirrje që parimi i unanimitetit të BE-së të hiqet.

Në vend të kësaj, një "shumicë e kualifikuar" duhet të jetë e mjaftueshme, tha ai në Fondacionin Konrad Adenauer të mërkurën.

Ky veprim do të shfuqizonte në mënyrë efektive të drejtën e vetos që aktualisht i lejon çdo njërit prej 27 shteteve anëtare të bllokojë vendime të mëdha, duke e bërë konsensusin "dukshëm" më të lehtë.

Megjithatë, unanimiteti, tha Wadepuhl, do të vazhdonte të ishte qëllimi.

Një shumicë e kualifikuar mund ta "bëjë BE-në të aftë të veprojë në fushat ku aktualisht duhet të mbetet në një ngërç", pohoi ai. "Nën udhëheqjen tonë, dymbëdhjetë shtete anëtare janë bashkuar tashmë për të sjellë këtë ndryshim", shtoi ai.

Në muajt e fundit, bllokimi i një kredie prej 90 miliardë eurosh për Ukrainën nga Hungaria, i udhëhequr nga kryeministri Viktor Orbán, shkaktoi polemika.

Orbán më parë ka rënë dakord për kredinë, por e ka zbatuar bllokadën pas dëmtimeve në tubacionin Druzbha, të cilat ndërprejnë përkohësisht furnizimet ruse me naftë në Hungari dhe Sllovakia.

Kryeministri hungarez më vonë e ndryshoi qëndrimin e tij pasi u mund nga Péter Magyar në zgjedhjet e vendit më 12 prill dhe që atëherë e ka miratuar kredinë. "E pamë këtë javën e kaluar kur u lëshuan fondet. Mjafton vetëm devijimi i disa personave ose edhe i individëve për të bllokuar veprimet e të gjithëve", tha Wadepuhl në Berlin.

Për më tepër, "bashkëpunimi i përfuruar" brenda bllokut duhet të vazhdojë të jetë në qendër të vëmendjes. "Nëse përparimi i përbashkët midis të 27 shteteve anëtare të BE-së nuk mund të arrihet në të ardhmen e parashikueshme, një grup më i vogël vendesh duhet të marrë drejtimin", tha Wadepuhl.

Sipas tij, ky parim duhet të zbatohet edhe për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së. Ai gjithashtu bëri thirrje për



reforma rrënjësore në ndarjen e fondeve të BE-së, duke mbështetur një "mekanizëm kushtëzim më të fortë".

Ndihma financiare, argumentoi ai, duhet të lidhet me respektimin e sundimit të ligjit, duke shtuar se "fondet e BE-së nuk duhet t'u shkojnë atyre që shkelin vlerat tona të përbashkëta".

Për shembull, BE-ja ngriu fondet për Hungarinë për shkak të shqetësimeve se qeveria e kryeministrit Viktor Orbán kishte shkelur vlerat thelbësore të BE-së. Akuzat përfshinin ndërhyrje politike në pavarësinë e gjyqësorit dhe kufizim të të drejtave të pakicave seksuale. Pasardhësi i

Orbán, Péter Magyar, tani po përpjeket të zhbllokojë këto fonde, me bisedimet midis Brukselit dhe Budapestit që pritet të përfundojnë më 25 maj.

Gjatë fjalimit të tij në Berlin të mërkurën, Wadepuhl trajtoi gjithashtu nevojën për të shkurtuar burokracinë brenda BE-së.

Aftësia e bllokut për të vepruar, tha ai, varet nga siguri që institucionet e tij të mbeten funksionale edhe ndërsa Unioni zgjerohet. Ndër idetë që ai paraqiti ishte një Komision Evropian më i vogël i përbërë nga komisionerë nga vetëm dy të tretat e shteteve

anëtare.

Wadepuhl bëri thirrje gjithashtu për ndryshime në përbërjen e Parlamentit Evropian. "Ne tashmë po shohim në nivel kombëtar sfidat që vijnë me një parlament të madh", tha ministri i Jashtëm.

Përpjekjet e Wadepuhl për të shkurtuar burokracinë e BE-së pasqyrojnë kërkesat më të gjera nga blloku konservator CDU/CSU i Gjermanisë.

Në një dokument politikash të parë nga Euronews, aleanca i kërkoi Ursula von der Leyen ta bënte BE-në më të thjeshtë dhe më efektive.

Lidhur me zgjerimin, Wadepuhl argumentoi se pranimet e ardhshme duhet të ndodhin gradualisht dhe jo në një hap.

Sipas tij, një qasje me faza mund të ndihmojë në kapërcimin e rezistencës ndaj disa vendeve candidate, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Ai nuk e përmendi në mënyrë të qartë Ukrainën, megjithëse propozimet për një formë anëtarësimi të kufizuar ose të pjesshëm në BE për Kievin janë diskutuar vazhdimisht në vitet e fundit.

## OVLUÇK-ja u dërgon letër ambasadave pas shtyrjes së aktgjykimit nga Specialja

PRISHTINË, 7 MAJ - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka njoftuar se të enjten zyrtarisht u është drejtuar ambasadave mike në Kosovë me një letër apeli për ruajtjen e besimit në drejtësinë ndërkombëtare. "Përmes kësaj letrë, OVLUÇK-ja kemi

shprehur shqetësimin lidhur me zvarritjet dhe zhvillimet e fundit në procesin gjyqësor në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, duke kërkuar që drejtësia ndërkombëtare të mbetet e paanshme, e drejtë dhe në përputhje me standardet universale të të drejtave të

njeriut. OVLUÇK-ja vlerëson mbështetjen e vazhdueshme të shteteve mike ndaj Kosovës dhe beson se ruajtja e besimit në drejtësi është jetike për paqen, stabilitetin dhe partneritetin ndërkombëtar", thuhet në njoftimin e OVLUÇK-së.



## "ALEATE E RËNDËSISHME": SHBA-ja SYNON PËRFSHIRJEN E KOSOVËS NË KORRIDORET RAJONALE TË ENERGJISË

PRISHTINË, 7 MAJ - I dërguari i posaçëm i Departamentit amerikan të Energjisë për integrimin energjetik, Joshua Volz, thotë se Uashingtoni po e rrit angazhimin e tij në Ballkanin Perëndimor për të forcuar sigurinë energjetike të aleatëve dhe për të ulur varësinë e tyre nga furnizimet ruse. Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, ai thekson se Rusia e ka përdorur vazhdimisht

energjinë si mjet gjeopolitik dhe se ShBA-ja synon t'i zëvendësojë "molekulat ruse" me burime të tjera energjetike përmes zgjerimit të infrastrukturës në Evropën Juglindore. Ai e përshkruan sigurinë energjetike si siguri kombëtare, duke e lidhur atë drejtpërdrejt me rritjen ekonomike, investimet dhe stabilitetin politik në rajon. Për Kosovën, Volz thotë se është

një aleate shumë e rëndësishme dhe një vend "në nevojë urgjente për modernizimin" e sistemit energjetik. "... kur kushtet e tregut të ndryshojnë dhe mjedisi i biznesit bëhet më tërheqës për investimet energjetike amerikane, Departamenti i Energjisë do të jetë i gatshëm të ndihmojë në lehtësimin e bashkëpunimit mes industrisë amerikane dhe partnerëve industrialë në Kosovë", thotë ai.



## DELEGACIONI I DEA-S TAKOHET ME POLICINË E KOSOVËS, DISKUTOHEN HETIMET PËR TRAFIKIMIN ME NARKOTIKË

PRISHTINË, 7 MAJ - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës u takua me atashen e vendit të Administratës Kundër Drogave (DEA), me seli në Sofje, Scott M. Caporossi, Analisten e Inteligjencës së DEA-s Kathleen (Kacey) Garrett, dhe Kimberly Riffe Atashe e DOJ/ICITAP në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara.

Ky takim, përtej natyrës së tij njohëse, shërbeu si një platformë për të diskutuar zhvillimin e iniciativave që synojnë avancimin e kapacitetit profesional të Policisë së Kosovës, si dhe thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në një takim të veçantë, delegacioni i DEA-s u takua me zyrtarë nga Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotik për të shqyrtuar rrugët për bashkëpunim të ardhshëm dhe zhvillim të aftësive.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë



së Kosovës, së bashku me ekipin e lartë të menaxhimit, shprehën vlerësimin e tyre të sinqertë për

mbështetjen dhe partneritetin e vazhdueshëm të ofruar Policisë së Kosovës dhe personelit të saj.

## NISIN PUNIMET PËR RINDËRTIMIN E RRUGËS KIJEVË-MALISHEVË

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri në detyrë i Infrastruktura dhe Transportit, Dimal Basha, mori pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve për projektin "Rikonstruktimi i rrugës rajonale R119, segmenti Kijevë - Malishevë". "Me rindërtimin e rrugës Kijevë-Malishevë, si Qeveri e Republikës së Kosovës po e bëjmë një investim tejet të rëndësishëm për banorët e Malishevës dhe të

mbarë zonës së Llapushës, e më gjerë", tha kryeministri në detyrë. Kurti theksoi se, përtej lidhjes së pesë fshatrave përgjatë segmenti Kijevë - Malishevë, rruga u shërben në baza ditore 18 fshatrave të zonës.

Ai shtoi se kjo rrugë e zhblokoi potencialin zhvillimor dhe e ndihmon turizmin, sepse krahas banorëve do të përdoret edhe nga qytetarët jo vetëm nga Kosova që shkojnë për t'i vizituar Ujëvarat e Mirushës.




## U.d. presidentja Haxhiu dekoron pas vdekjes Rexhep Qosjen me titullin "Nderi i Republikës së Kosovës"

PRISHTINË, 7 MAJ - Ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, ka dekoruar pas vdekjes akademik Rexhep Qosjen me titullin "Nderi i Republikës së Kosovës".

Haxhiu ka thënë se Rexhep Qosja ishte një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë, shkencës dhe mendimit shqiptar. "Me veprën e tij të gjerë, me qëndrimin e tij

publik dhe me përkushtimin ndaj çështjeve të mëdha të kombit, ai la gjurmë të thella në kulturën shqiptare dhe në vetëdijen tonë kombëtare. Ky titull është shenjë

mirënjohjeje për një jetë të tërë në shërbim të dijes, lirisë dhe dinjitetit kombëtar. I përjetshëm qoftë kujtimi për të", ka shkruar në rrjetet sociale Haxhiu.





# PALATOVA: KOSOVA DUHET T'I BINDË 27 SHTETET ANËTARE PËR STATUSIN E KANDIDATIT NË BE

Ushtruesja e detyrës së sheshe të Zyrës së BE-së në Kosovë, Eva Palatova, ka thënë se Kosova nuk mund ta marrë automatikisht statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se vendi duhet t'i bindë të 27 shtetet anëtare të BE-së. Në kuadër të shënimit të Ditës së Evropës, më 9 maj, në një organizim të Zyrës së BE-së në Kosovë, ajo ka potencuar se Brukseli pret nga Kosova zgjedhje të lira dhe të drejta, formim të shpejtë të institucioneve dhe avancim të reformave

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat dhe të hapen negociatat për anëtarësim, duke thënë se vendi nuk duhet të mbetet prapa në procesin integruar evropian. Në kuadër të Ditës së Evropës, e cila shënohet më 9 maj, në një ngjarje të organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ku u nda edhe Çmimi Evropian i Vitit, Kurti ka thënë se Kosova tashmë ka dëshmuar progres në ekonomi, demokraci dhe sundim të ligjit. "Për Kosovën, Bashkimi Evropian nuk është një realitet i largët apo një grup standardesh që duhen përbushur. Ai është shtëpia natyrore e shoqërisë sonë, korniza e reformave tona dhe e ardhmja e qytetarëve tanë që tashmë është zgjedhur. Më shumë se 80% e qytetarëve tanë mbështesin anëtarësimin në Bashkimin Evropian, një nga nivelet më të larta të mbështetjes kudo në Evropë", është shprehur Kurti, duke theksuar se Kosova ka shënuar progres të konsiderueshëm në disa fusha kyçe, duke përmendur rritjen

ekonomike dhe avancimin demokratik. "Ne kemi bërë përparim të konsiderueshëm në vendin tonë. Kemi një nga normat më të forta të rritjes ekonomike në Evropën Juglindore dhe më të fortën në Ballkanin Perëndimor. Jemi në krye kur bëhet fjalë për avancimin demokratik, qoftë sipas matjeve të World Justice Project, Freedom House, Transparency International apo World Press Freedom Index. Ne jemi gjithashtu vendi më i sigurt në rajonin tonë me nivelin më të ulët të krimit. I gjithë ky përparim mori njohje në rrugën tonë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Pas një dekade pritjeje, ne tashmë gëzojmë liberalizimin e vizave dhe morëm vendimin historik për të aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 15 dhjetor 2022", ka deklaruar ai.

Kurti ka shtuar se Kosova është pjesë e Planit të Rritjes së BE-së dhe po punon në përbushjen e obligimeve, ndonëse, sipas tij, ekzistojnë pengesa për shkak të mosmiratimit të disa ligjeve në Kuvend. "Ne jemi pjesë e Planit të Rritjes, ku po bëjmë çdo përpjekje për të zbatuar secilin hap. Ne përballemi me disa sfida

këtu, siç e dini mirë, me ligje që ende duhet të miratohen nga Kuvendi. Muajin e kaluar, më 15 prill, shënuam 40 muaj që kur dorëzova aplikimin tonë për anëtarësim në Pragë. Besoj se BE-ja duhet të punojë së bashku për të siguruar statusin e kandidatit për Kosovën dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit. Duhet të ketë unitet angazhimi në BE në mënyrë që Kosova të mos mbetet prapa. Ndërkohë, derisa presim vendimin e BE-së, ne po ndërmarrim hapa konkretë për të siguruar që të mos humbet kohë nga ana jonë", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka theksuar se procesi i zgjerimit dhe reformat duhet të ecin paralelisht. "Premtimi juaj është zgjerimi. Premtimi ynë janë reformat, dhe ne mundemi dhe duhet t'i realizojmë të dyja, kjo është një përgjegjësi e përbashkët", ka deklaruar ai. Ndërkaq ushtruesja e detyrës së sheshe të Zyrës së BE-së në Kosovë, Eva Palatova, ka thënë të enjten se Kosova nuk mund ta marrë automatikisht statusin e kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se vendi duhet t'i bindë të 27 shtetet anëtare të BE-së. Në kuadër të shënimit të Ditës së

Evropës, më 9 maj, në një organizim të Zyrës së BE-së në Kosovë, ajo ka thënë se Brukseli pret nga Kosova zgjedhje të lira dhe të drejta, formim të shpejtë të institucioneve dhe avancim të reformave. "E di, z. kryeministër, që ju dëshironi që BE-ja të ecë përpara me aplikimin për anëtarësim, të cilin e dorëzuat gjatë presidencës çeke në Pragë. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar që ta arrini këtë synim të radhës. Por më lejoni të jem e sinqertë, Brukseli nuk mund ta japë thjesht statusin e kandidatit. Ju duhet t'i bindni 27 shtetet anëtare", ka pohuar ajo.

Palatova ka theksuar se Kosova duhet të vazhdojë të dëshmojë standarde demokratike dhe stabilitet institucional. "Dhe për këtë, rëndësi kanë këto tri elemente kyçe. Kosova është dhe duhet të mbetet një demokraci e gjallë. Zgjedhjet parlamentare që mbahen saktësisht një muaj nga sot duhet të jenë, përsëri, të lira, të drejta dhe gjithëpërfshirëse", ka thënë ajo.

Palatova ka shtuar se Bashkimi Evropian pret krijimin e shpejtë të institucioneve pas zgjedhjeve dhe vazhdimin e reformave. "Së dyti, shpresojmë të shohim një formim të shpejtë të institucioneve. Një qeveri e bazuar në një shumicë të fortë në kuvend, e aftë të gjenerojë kompromise të fuqishme ndërpartiake, të zgjedhë një president dhe të avancojë me agjendën e reformave. Dhe sigurisht, karakteri shumetnik i Kosovës është me vlerë të madhe për të gjitha shtetet tona

anëtare", është shprehur ajo. Sipas saj, shtetet anëtare të BE-së po e përcjellin mënyrën se si Kosova i trajton komunitetet joshumicë dhe zbatimin e marrëveshjeve të dialogut. "Të gjitha kryeqytetet tona vëzhgojnë ruajtjen e tij, angazhimin konstruktiv me të gjitha komunitetet shumicë, në mënyrë që të gjithë kosovarët, pavarësisht përkatësisë etnike, të ndiejnë se kanë një shtëpi dhe perspektivë këtu. Në këtë drejtim, ne mbështetemi në zbatimin e mëtejshëm të marrëveshjes së 14 marsit. Dhe e di, zoti Kryeministër, që ju ia rikonfirmuat këtë përfaqësuesit të lartë edhe këtë javë në Jerevan", ka deklaruar Palatova. Sipas saj, BE-ja pret zbatim me mirëbesim të marrëveshjeve dhe progres në dialogun e lehtësuar nga Brukseli. "Ne llogarisim në zbatim me mirëbesim, llogarisim që momentumi që krijon kjo marrëveshje t'i japë një shtysë të mëtejshme zgjidhjeve konkrete dhe progresit në dialogun e ri të lehtësuar. Ne llogarisim që mbi këtë bazë, përmes bashkëpunimit të udhëheqjes së Kosovës në të gjitha partitë politike, statusi i kandidatit të bëhet i prekshëm dhe premtimi nga Samiti i Selanikut i vitit 2003 të bëhet një perspektivë e arritshme. Tani, dua gjithashtu të jem i qartë se Bashkimi Evropian i vitit 2003 nuk është Bashkimi Evropian i vitit 2026", ka thënë ushtruesja e detyrës së sheshe të Zyrës së BE-së në Kosovë, Eva Palatova.



# KURTI: S'KEMI SITUATË TË RE, POR ZGJEDHJE PËR TA PËRSËRITUR E TEJKALUAR REZULTATIN E 28 DHJETORIT

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka folur të enjten për situatën e fundit politike në vend.

Ai ka thënë se vendi nuk ndodhet në një situatë të re, por se po shkon në zgjedhje "për ta përsëritur e tejkaluar rezultatin e 28 dhjetorit".

Kurti ka thënë se partitë politike kanë afat deri më 12 maj për dorëzimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet e 7 qershorit, ndërsa para dorëzimit të kësaj liste, LV-ja do të mbajë mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të saj. "Sa i përket zgjedhjeve të ardhshme, natyrisht ju e dini që data është caktuar 7 qershori dhe kjo ka imponuar që deri më datën 12 maj ne t'i dorëzojmë listat e kandidatëve tanë për deputetë, pra i kemi edhe pesë ditë. Do të kemi mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes

Vetëvendosje, do të kemi ndoshta edhe ja dy mbledhje të kryesisë së LV-së deri atëherë. Unë nuk mund të flas për emra, por ajo që e di është që se jemi duke e zbatuar programin dhe zotimet tona me të cilat i kemi fituar zgjedhjet e 28 dhjetorit dhe 28 dhjetori nuk ishte para pesë vjetësh, por i bie para katër muajve. Rrjedhimisht, nuk mund të themi që kemi një situatë krejtësisht të re. Kemi zgjedhje të përsëritura që nuk ka qenë e thënë të mbahen, mirëpo meqë bojkotoi opozita, meqë nuk dëshiroi të jetë as minimalisht konstruktive, ja po shkojmë edhe njëherë drejt 7 qershorit për ta përsëritur e tejkaluar 28 dhjetorin", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se qytetarët janë ata që vendosin për pushtetin politik në vend dhe jo liderët partiakë apo pretendentët për

poste të caktuara, derisa ka rikujtuar rezultatin e zgjedhjeve të 28 dhjetorit, ku siç tha ai, Lëvizja Vetëvendosje mori 51.1 për qind të votave.

Kurti ka thënë se të gjithë ata që kanë ambicie politike duhet të angazhohen dhe të punojnë për qytetarët, por sipas tij, vendimin përfundimtar e merr populli.

Ai ka theksuar se në zgjedhjet e fundit, Lëvizja Vetëvendosje iu afrua shifrës prej 500 mijë votash dhe siguroi 57 deputetë në Kuvendin e Kosovës. "Të gjithë të cilët kanë ambicie politike, duan pushtet, kanë vizion e ide për të mirën e qytetarëve, le të angazhohen, le të punojnë me çka dinë e munden dhe iu dëshiroj sukses. Por duhet ta keni parasysh që për këtë gjë nuk vendos asnjë kryetar partie, asnjë pretendent për çfarëdo posti, për këtë vendos populli. Dhe mos harroni qysh ka

vendosur populli para katër muajsh. Pra, populli në zgjedhjet e 21 dhjetorit, 51.1%. Jo 50%, 51, jo 51, po 51.1% ia dha Lëvizjes Vetëvendosje, me ç'rast ne iu afruam shumë pranë asaj shifre 500.000 vota apo 500.000 zemra, siç themi ne, dhe vetëm shikoni rezultatin konkret. Lëvizja Vetëvendosje 57 deputetë. Ndërkaq LDK, PDK, AAK së bashku 43 deputetë. Pra, ato tria bashkë 43 deputetë", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se krahas 57 deputetëve të Vetëvendosjes dhe partnerëve të saj politikë, koalicioni ka edhe mbështetjen e deputetëve të komuniteteve joshumicë, duke arritur në total 66 deputetë. "Ne, Lëvizja Vetëvendosje me partinë Guxo, edhe Alternativën e PSHDK-në, 57 deputetë. Pra nuk jemi duke u krahasuar dy parti, po e gjithë opozita është 43 deputetë e

Vetëvendosja është 57, plus ne i kemi edhe 9 deputetë të komuniteteve joshumicë, përkatësisht pakicave, gjithsej bëjmë 66. Rrjedhimisht, shikoni, njerëzit kanë dëshira dhe kjo është normale, por nuk duhet me i ngatërruar dëshirat me faktet", është shprehur Kurti.

Sipas tij, qytetarët e Kosovës e kanë kuptuar se përpjekjet për ta penguar Lëvizjen Vetëvendosje kanë sjellë rritje të mbështetjes për këtë subjekt politik. "Po besoj se qytetarët e Republikës e kanë kuptuar që çdo herë kur përpiqesh t'ia vësh digën një rrjedhe socio-historike e politike qysh është Lëvizja Vetëvendosje, atëherë do të ketë gjithmonë më shumë prurje. Pra, sa herë na kanë vënë diga, është rritur prurja. E tash bash saktësisht sa do të jetë, do ta marrim vesh në mbrëmjen e 7 qershorit", ka thënë Kurti.

## OSBE-ja kërkon profesionalizëm dhe pavarësi politike për organet drejtuese të RTK-së dhe KPM-së

Prishtinë, 7 maj- Misioni i OSBE-së ka reaguar pas emërimit të kryesuesve të rinj të bordeve të Radio Televizionit të Kosovës dhe Komisionit për Media.

Në një njoftim publik, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka theksuar rëndësinë e ushtrimit të mandateve me profesionalizëm dhe integritet. "Inkurajojmë udhëheqësinë e re që t'i

përbushë mandatet e tyre me profesionalizëm dhe integritet. Respektimi i plotë i parimeve të pavarësisë, transparencës dhe llogaridhënies, të përcaktuara në kornizat ligjore në fuqi, mbetet jetik", thuhet në reagim. Tutje, OSBE-ja ka vlerësuar rëndësinë e mediave publike dhe organeve rregullatore të pavarura për lirinë e medias dhe besimin publik. "Mediat publike



të pavarura dhe të qeverisura në mënyrë efektive, si dhe organet rregullatore, janë thelbësore për

lirinë e medias, pluralizmin dhe besimin e publikut", theksohet në njoftim.

Misioni i OSBE-së po ashtu ka bërë thirrje që vendimmarrja të bazohet në meritë dhe të shmangët ndikimi politik në ushtrimin e detyrave. "Vendimmarrja e bazuar në meritë dhe shmangia e ndikimit politik në ushtrimin e detyrave të tyre mbeten parësore", thuhet

më tej. Në fund, OSBE-ja ka ritheksuar mbështetjen për forcimin e pavarësisë së institucioneve mediale në Kosovë. "Misioni mbetet i përkushtuar për të mbështetur përpjekjet që forcojnë pavarësinë dhe funksionimin e duhur të institucioneve mediale në Kosovë", thuhet në reagimin e OSBE-së.

## Ish-deputetja e LV-së, Jeta Statovci, i bashkohet rrugëtimit të ri politik të Vjosa Osmanit

PRISHTINË, 7 MAJ - Jeta Statovci i është bashkuar rrugëtimit të ri politik të ish-presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, në vazhden e bashkëpunimit të tyre.

Osmani tha se rrugëtimi i përbashkët me Statovcin është vazhdimësi e një angazhimi të bazuar në vlera dhe vizion. "E nisëm bashkë rrugëtimin në Kuvend. Dhe bashkë po vazhdojmë drejt Kuvendit", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Ajo theksoi se lidhja mes tyre është forcuar në një fazë të re të angazhimit politik. "Na kanë bashkuar ndër vite virtyti, vizioni, vullneti dhe e vërteta", u shpreh Osmani.

Sipas saj, ky bashkëpunim tashmë është pjesë e një rruge të re politike që po ndërtohet mbi të njëjtat parime. "Mbi të gjitha, na bashkojnë vlerat mbi të cilat e nisëm këtë rrugëtim", tha ajo.

Osmani shtoi se kur këto vlera

devijojnë, angazhimi i tyre rihet në drejtim të qëllimeve të përbashkëta për vendin. "E kur ato devijojnë, ne ringrihem në këmbë, për dashurinë ndaj vendit dhe për rrugëtimin e sigurt të Kosovës", përfundoi ajo.

Statovci ka qenë deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e Listës Guxo, si pjesë e bashkimit dhe bashkëpunimit politik me Lëvizjen Vetëvendosje.



# PËRKUJTOHET HEROI BAHRI FAZLIU, NJË NDËR FIGURAT MË TË NDRITURA TË LËVIZJES KOMBËTARE PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS

PRISHTINË, 7 MAJ - Më 7 maj të vitit 1998 në vendin e quajtur Bogiqe në trekëndëshin kufitar shqiptar: Mali i Zi - Kosovë - Shqipëri bie heroikisht Bahri Fazliu. Për disa vjet jetoj në ilegalitet dhe ishte kryeredaktor i revistës "Çlirimi", e cila botohej nga LKÇK-ja.

Ishte vëlla i heroit Fahri Fazliut, i cili më 2 nëntor 1989 së bashku me Afrim Zhitinë bien heroikisht në një betejë me policinë serbe në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë. Bahri Fazliu ishte themelues i LKÇK-së dhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me rastin e 28-vjetorit të rënies së heroit Bahri Fazliut, të enjten liderë institucional dhe partiakë, e bashkëveprimtarë kanë bërë homazhe te varri i tij në Prishtinë.

Kryeministrit në detyrë, Albin Kurti bashkë me ministrin në detyrë për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare, Andin Hotin, kanë bërë homazhe pranë varrit të Bahri Fazliut, në 28-vjetorin e rënies së tij.

Kurti, pasi bëri homazhe tha se Bahri Fazliu ishte luftëtar i orëve të para të përpjekjeve tona çlirimtare.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj së bashku me bashkëpartiakë, ka bërë homazhe, duke theksuar se heroit Bahri Fazliu është një ndër figurat më të ndritura të Lëvizjes Kombëtare për çlirimin e Kosovës. "Trim, guximtar dhe i vendosur deri në vetëmohim, fitoi përjetësinë 28 vjet më parë, duke u bërë shembull për rininë shqiptare se si duhet Atdheu dhe si



sakrifikohet për të. Së bashku me familjen, bashkëveprimtarë dhe bashkëluftëtarë, sot bëmë homazhe pranë varrit ku pushon trupi i tij, duke nderuar jetën dhe veprën e tij në shërbim të atdheut. Lavdi Bahri Fazliut dhe gjithë dëshmorëve që ranë duke mbrojtur nderin e luftëtarit shqiptar", ka thënë lideri i AAK-së.

Edhe kryetari i Komunës së Rahovecit, bashkëveprimtar i Bahriut, Smajl Latifi, ka marrë pjesë në 28-vjetorin e rënies së

heroit Bahri Fazliut. "Sot, me nderim të thellë e krenari kombëtare, kujtojmë një prej mendjeve dhe figurave më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, Heroit Bahri Fazliu - Gzimi. Bahriu ishte shumë më tepër se një luftëtar. Ai ishte ideologu i veprimit, zëri që zgjonte ndërgjegjen kombëtare dhe prijësi që e kuptoi herët se liria nuk fitohet me pritje, por me organizim, sakrificë dhe luftë të pandalur kundër robërisë. Në

kohën kur shumëkush kërkonte paqe brenda nënshtrimit, Bahriu ngriti flamurin e rezistencës dhe u bë frymëzim për brezin që mori armët për liri", ka thënë Latifi, duke shtuar se ai jetoj pak, por la pas një trashëgimi të pavdekshme politike, kombëtare dhe atdhetare.

"Veprimtaria e tij në ilegalitet, puna organizative, artikujt mobilizues përmes revistës ilegale të kohës "Çlirimi" dhe guximi i rrallë në kohët më të rënda, e bënë Bahri Fazliun një

nga shtyllat më të fuqishme të luftës çlirimtare. Rënia e tij më 7 maj 1998 ishte goditje e rëndë për Lëvizjen dhe për gjithë rrugën tonë të çlirimit, por njëkohësisht u kthye në kushtrim të madh për vazhdimin e luftës deri në fitore. Emri i Bahri Fazliut mbetet i lidhur përjetësisht me idealin e lirisë, dinjitetit kombëtar dhe bashkimit shqiptar. Sot, pas 28 vjetësh, amaneti i tij vazhdon të jetojë në ndërgjegjen tonë si obligim për ta mbrojtur të vërtetën, për të ruajtur idealin kombëtar dhe për të mos lejuar që sakrificat e dëshmorëve të zbehët nga harresa apo nga deformimi i historisë. Lavdi e përjetshme Heroit të Kombit, Bahri Fazliut - Gzimit!", ka thënë kryetari Latifi.

Edhe Valon Murati, bashkëveprimtar i Bahri Fazliut bashkë me kolegë ka bërë homazhe pranë varrit të këtij të fundit në 28-vjetorin e rënies së tij.

Murati ka thënë se Bahri Fazliu përpos që ishte luftëtar i kombit, ishte edhe shkrimtar dhe poet. "Sot jemi mbledhur këtu bashkërisht për të nderuar në 28-vjetorin e rënies shokun tonë të dashur, bashkëluftëtarin, një prej udhëheqësve, ideologëve politikë të luftës çlirimtare, Bahri Fazliun - Gzimin, i cili në moshën 28-vjeçare ka rënë në trekufrin midis Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi, në atë tre kufi për të cilin ka luftuar për ta hequr dhe ka luftuar për t'i çliruar shqiptarët edhe për t'i bashkuar", ka thënë Murati. Sipas tij, Fazliu bashkë me gjithë dëshmorët e tjerë kanë ndikuar që Kosova të çlirohet.

## Aida Dërguti i bashkohet PDK-së

PRISHTINË, 7 MAJ - Ish-deputetja e LV-së, Aida Dërguti, i është bashkuar të enjten Partisë Demokratike të Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije lideri i kësaj partie, Bedri Hamza, teksa e ka

vlerësuar Dërgutin si një aktiviste të dalluar dhe qytetare të përgjegjshme, para se të jetë politikane. "Sot e mirëpritja në Partinë Demokratike të Kosovës, Aida Dërgutin, një aktiviste të

dalluar dhe qytetare të përgjegjshme, para se të jetë politikane. Një zonjë që, për dekada me radhë, ka pasur vetëm një qëllim: t'i shërbejë Kosovës, në çfarëdo kapaciteti

që i është besuar. Për Aidën, siç e dinë të gjithë, drejtësia është mbi të gjitha detyrë. Dhe, në këtë mision, do të punojmë bashkë. Mirë se erdhe në PDK, Aida!", ka shkruar Hamza në "Facebook".



## Maqedonci takon homologun Mbretërisë së Bashkuar, flasin për avancimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes

Prishtinë, 7 maj- Gjatë vizitës zyrtare në Turqi, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci u takua me ministrin e Shtetit për Mbrojtje të Mbretërisë së Bashkuar, Lord Vernon Coaker. Gjatë takimit, ministri shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe rolin e rëndësishëm që Mbretëria e Bashkuar ka dhënë gjatë procesit shtetformues të Republikës së

Kosovës, si dhe në forcimin e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes.

Po ashtu, diskutuan për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes, duke vlerësuar partneritetin e deritanishëm në kuadër të misionëve të përbashkëta në Ishujt Falkland dhe Belize, si dhe kontributin në operacionin Interflex.

Në frymën e partneritetit ndërmjet dy vendeve mike dhe aleate, u ritheksua përkushtimi i ndërsjellë për thellimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët, përfshirë trajnimet, zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe rritjen e ndërveprueshmërisë ushtarake, në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e ndërkombëtar.



## RRYMA NUK U SHTRENTJUA SIVJET - POR ÇKA FSHIHET PAS KËSAJ?

PRISHTINË, 7 MAJ - Qytetarët e Kosovës përfundimisht i shpëtuan një rritjeje të dytë radhazi të çmimit të faturës së energjisë elektrike, por kjo nuk nënkupton se ata nuk do të përballen me një rritje të mundshme vitin e ardhshëm. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) vendosi më 5 maj kundër shtrenjtimit të tarifave të rrymës, me gjithë kërkesat e kompanive kyç për furnizimin me rrymë në vend. Ky lehtësim vjen pas shtrenjtimit prej 16 për qind vitin e kaluar, të cilit i kishin paraprirë rritje të tjera më 2023 dhe 2022.

### Pse nuk u rrit çmimi i rrymës sivjet?

Rregullatori i energjisë vendosi t'i hedhë poshtë kërkesat e tri kompanive kyç të sistemit energjetik në vend për rritje prej 20 për qind.

ZRRE - e cila bën shqyrtimin dhe përcaktimin vjetor të tarifave të energjisë elektrike në pranverë - nuk dha arsye specifike për këtë, por tregoi se një pjesë e kostove për sigurimin e energjisë elektrike nuk është përfshirë në tarifën e sivjetme.

Dhe, kjo ka mundësuar shmangien e shtrenjtimit të tarifave sivjet.

Ymer Fejzullahu, kryesues i bordit të ZRRE-së, tha se përmes një mekanizmi të profilizimit, kostot shtesë nuk përfshihen në tarifën e vitit 2026, por shpërndahen gradualisht duke filluar nga viti 2027. "Në mënyrë që kostot që lidhen për remontet dhe mungesën e prodhimit nga gjeneratorët vendorë të shpërndahen në një periudhë dyvjeçare. Kjo bëhet për të zbutur ndikimin financiar te konsumatorët dhe, njëkohësisht, për të garantuar

sigurinë e furnizimit me energji elektrike", tha Fejzullahu.

### A mund të ketë shtrenjtim më 2027?

Mbajtja e tarifave të pandryshuara nuk nënkupton se nuk do të ketë përsëri kërkesa nga kompanitë energjetike për rritje të çmimit.

Madje, tarifën e energjisë elektrike mund të rriten edhe më shumë vitin e ardhshëm, paralajmëron Adhurim Haxhimusa, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Grisons të Zvicrës. "Nëse Kosova gjatë këtij viti importon më shumë energji sesa është planifikuar, atëherë rrezikohet që tarifën të rriten në vitin 2027 shumë më shumë se sa është pritur", tha Haxhimusa për Radion Evropa e Lirë.

Kosova nuk mund ta sigurojë energjinë e nevojshme për mbi 1.6 milion banorët e vet vetëm me prodhimin nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), prandaj importi është i pashmangshëm.

KEK - korporata shtetërore dhe prodhuesi mbizotërues i rrymës në vend - mund t'i prodhojë deri në 800 megavat në orë, kurse nevojat e vendit, në një ditë dimri, për shembull, arrijnë deri në 1.300 megavat në orë.

Prandaj, vendi detyrohet të importojë rrymë nga jashtë për t'i mbuluar nevojat e konsumatorëve.

Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se vendi kishte importuar rrymë në vlerë të rreth 248 milionë eurove në periudhën janar-nëntor 2025, ndërsa kishte eksportuar në vlerë të rreth 48 milionë eurove.

### Cilat ish-in kërkesat e kompanive energjetike?

Operatori i Sistemit, Transmisionit



dhe Tregut [KOSTT], Kompania për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë [KEDS] dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike [KESCO], kërkuan rritje të çmimit të tarifave siç bëjnë rëndom çdo vit.

KESCO - shpërndarësi i rrymës - kërkoj rritje mbi 20 për qind të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2026 duke u thirrur në sasinë e madhe të importit të energjisë elektrike.

KEK, ndërkaq, ka thënë në aplikim se ka paraparë vazhdimin

e projekteve të rehabilitimit të njësisë gjeneruese, kësaj radhe në termocentralin Kosova B, me një kohëzgjatje të planifikuar prej rreth tetë muajsh.

KESCO u arsyetua se kjo situatë pritet ta kufizojë prodhimin vendor dhe të rrisë varësinë nga importi.

### Sa kushton rryma në Kosovë?

Sipas tarifave të tanishme, Konsumatorët që shpenzojnë

deri në 800 kilovat në orë në muaj paguajnë 9.05 centë për kilovat, ndërsa ata që shpenzojnë mbi këtë prag paguajnë 15.43 centë për kilovat.

Kurse tarifën e lira që shfrytëzohen gjatë natës nga ora 23:00 deri në 08:00 të mëngjesit, konsumatorët për një kilovat paguajnë 3.88 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovat. Ndërkaq, ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë paguajnë 7.28 centë për kilovat.

## Për herë të parë me ekipe multidisciplinare për ndërhyrje në fëmijërinë e hershme

PRISHTINË, 7 MAJ - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ për Kujdesin Parësor Shëndetësor, i cili

rregullon ndërhyrjen në fëmijërinë e hershme si pjesë të shërbimeve në kujdesin parësor. "Ky ndryshim krijon bazën për mbështetje të hershme për

foshnjat dhe fëmijët me rrezik për vonesa në zhvillim, përmes ekipeve profesionale multidisciplinare me psikologë klinikë, fizioterapeutë, logopedë

dhe punëtorë socialë. Po e afrojmë mbështetjen profesionale më pranë fëmijëve dhe familjeve", ka shkruar Vitia në "Facebook".



## Rritje e lehtë e indeksit të përgjithshëm i inputeve në bujqësi

PRISHTINË, 7 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Inputeve në Bujqësi për tremujorin e parë (TM1) 2025. Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinarë, në kompani, tregje dhe vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion.

Në TM1 2026, Indeksi i Input 1 ka rritje për 5,4 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Kurse, Indeksi i Input 2 ka rritje për 3,7 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 4,5 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Produktet që e përbëjnë bazën për Indeksin e çmimeve të

inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues

të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje tjera), ndërtesat dhe të tjera



(ndërtesat jo-rezidente të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës).

## BQK-ja PËRFESHIN ARIN NË PORTOFOLIN E REZERVAVE PËR HERË TË PARË

**EPOKA E RE**

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 7 MAJ - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka shënuar një moment historik në zhvillimin e aseteve zyrtare rezervë të Republikës së Kosovës, me përfshirjen e arit për herë të parë në portofolin e rezervave të saj. Ky zhvillim përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale dhe reflekton modernizimin e vazhdueshëm të kornizës së menaxhimit të rezervave të BQK-së.

Përfshirja e arit forcon më tej diversifikimin, qëndrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të portofolit rezervë, duke përafuar praktikën investuese të BQK-së me standardet dhe praktikën bashkëkohore ndërkombëtare, si dhe me praktikën e shëndosha të bankave qendrore.

Gjatë viteve të fundit, BQK-ja ka ndërmarrë një transformim gjithëpërfshirës të praktikave të menaxhimit të aseteve, administrimit dhe menaxhimit të rrezikut. Këto reforma janë mbështetur në politika të mirëpërcaktuara të brendshme, mekanizma të forcuar të qeverisjes dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerë ndërkombëtarë, përfshirë



Thesarin e SHBA-së, Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore.

Një shtyllë kyçe e këtij progresi ka qenë pjesëmarrja e BQK-së në Programin e Partneritetit për Këshillim dhe Menaxhim të Rezervave të Bankës Botërore (RAMP), fillimisht e fokusuar në asistencë teknike dhe së fundmi e avancuar përmes një Mandati për Menaxhimin e Investimeve.

Ky bashkëpunim ka mbështetur forcimin e kornizës së politikave investuese të BQK-së, rregulloreve mbështetëse, kapaciteteve institucionale, si dhe

funksioneve të menaxhimit të rrezikut, monitorimit dhe analizës.

Paralelisht, BQK-ja ka zbatuar një strategji të rishikuar për marrëdhëniet bankare korrespondente dhe kujdestarinë e aseteve, përfshirë vendosjen e marrëdhënieve me banka qendrore brenda Eurosishtimit dhe me banka ndërkombëtare komerciale me reputacion.

BQK-ja ka avancuar gjithashtu angazhimin me ofrues kyç të infrastrukturës globale, përfshirë Clearstream, për shërbime të menaxhimit të kolateralit dhe

kujdestarisë së aseteve.

Këta hapa kanë zgjeruar mundësitë e BQK-së për të menaxhuar likuiditetin në mënyrë efektive, duke rritur njëkohësisht kapacitetin e saj operacional dhe strategjik për menaxhimin e rezervave në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Përfshirja e arit në portofolin e rezervave të Kosovës për herë të parë përfaqëson hapin fillestar të një procesi afatgjatë të alokimit strategjik, duke reflektuar progresin më të gjerë institucional të BQK-së.

Ajo ndërtohet mbi qëndrueshmërinë tashmë të konsoliduar financiare të BQK-së, qeverisjen e shëndoshë dhe kornizën e kujdeshme të politikave. Përmes menaxhimit të kujdeshëm financiar, alokimit efektiv të aseteve dhe qeverisjes së brendshme të fuqizuar, BQK-ja ka ruajtur një model institucional të qëndrueshëm, duke i mundësuar edhe realizimin e kontributeve të rregullta vjetore në buxhetin e shtetit, në përputhje me kornizën e saj ligjore.

Ari tradicionalisht ka luajtur rol të rëndësishëm në menaxhimin e rezervave të bankave qendrore, si instrument afatgjatë i ruajtjes së vlerës dhe i diversifikimit.

Për BQK-në, përfshirja e tij përfaqëson një hap strategjik drejt forcimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë së portofolit rezervë, zbutjes së rreziqeve dhe mbështetjes së stabilitetit financiar afatgjatë.

BQK-ja mbetet e përkushtuar për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe për sigurimin që praktikën e menaxhimit të rezervave të vazhdojnë të mbështesin stabilitetin financiar, besueshmërinë institucionale dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës.

## AKB-ja: Duke ndëshkuar Shqipërinë nuk mbrohet tregu vendor!

PRISHTINË, 7 MAJ - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me masat dhe qasjen e fundit të Ministrisë së Bujqësisë dhe AUV-së ndaj produkteve të importuara, veçanërisht atyre me origjinë nga Shqipëria.

Shahini në reagimin për medie ka theksuar se Kosova është nënshkruar e marrëveshjes CEFTA dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, marrëveshje këto që garantojnë lëvizjen e lirë të mallrave,

konkurrencën e ndershme dhe eliminimin e barrierave jo-tarifore në tregti. "Mbrojtja e konsumatorit dhe mbështetja e prodhimit vendor janë të domosdoshme, por ato nuk duhet të shndërrohen në masa administrative që pengojnë qarkullimin e mallrave dhe krijojnë barriera të fshehta tregtare ndaj produkteve 'Made in Albania'. Për bizneset e Kosovës dhe për AKB-në, tregu i Shqipërisë konsiderohet treg kombëtar, ashtu si edhe tregu i Kosovës për bizneset shqiptare. Çdo pengesë artificiale në kufi,

çdo vonesë e panevojshme apo trajtim selektiv i produkteve shqiptare dëmton jo vetëm ekonominë shqiptare, por edhe vetë bizneset, konsumatorët dhe partneritetin ekonomik mbarëkombëtar", është thënë në reagimin e kryetarit të AKB-së, Agim Shahini.

AKB-ja vlerëson se standardet e sigurisë ushqimore duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha produktet, pa diskriminim dhe pa krijuar klimë pasigurie për importuesit dhe prodhuesit shqiptarë. "Në vend të

barrierave dhe kontrolleve selektive, institucionet duhet të fokusohen në luftimin e produkteve jokualitative pa dallim origjine, harmonizimin e standardeve Kosovë - Shqipëri, lehtësimin e procedurave doganore dhe fitosanitare si dhe krijimin e një tregu unik ekonomik shqiptar. AKB-ja kërkon që institucionet e Kosovës të respektojnë frymën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe partneritetin strategjik Kosovë - Shqipëri, duke mos krijuar precedentë që mund të dëmtojnë raportet ekonomike



ndërmjet dy vendeve tona. Ekonomia kombëtare nuk forcohet me barriera mes shqiptarëve, por me bashkëpunim, standarde dhe treg të përbashkët", ka thënë Shahini.

# KËRCËNO, TËRHIQU: TË GJITHA 'PRAPAKTHEHU'-T E DONALD TRUMPIT



Nga Massimo GAGGI

Një muaj më parë, kërcënimi i Donald Trumpit për të zhdukur brenda një nate qytetërimin iranian. Më pas, në agim, armëpushimi i vendosur duke pretenduar se Teherani po bënte lëshime që, në realitet, nuk u materializuan kurrë. Dhe tani, operacioni Project Freedom për të çliruar anijet e bllokuara në Ngushticën e Hormuzit, i pezulluar pas vetëm një dite, dy orë pas konferencës për shtyp në të cilën sekretari i Shtetit Marco Rubio e kishte përshkruar me entuziazëm rolin e tij thelbësor, mbrojtës, një dhuratë e ofruar nga SHBA për mbarë botën. Këto janë vetëm dy nga qëndrimet e vazhdueshme kontradiktore të Donald Trumpit, i cili, në menaxhimin e luftës me Iranin, ka arritur të përgënjeshtrijë vetveten, edhe brenda pak orësh: më 1 prill, në mëngjes, tha se lufta do të mbaronte brenda tre ditësh. Në mbremje foli për dy ose tre javë. Dhe pak ditë më parë, pasi kishte dërguar një letër në Kongres ku pohonte se nuk kishte nevojë për një votim parlamentar për të autorizuar një luftë, sepse ajo me Iranin ishte vetëm një operacion

ushtarak, në një miting në mbremje deklaroi se Amerika është në luftë.

## Tre "urdhëresat" që Roy Cohn i dha Donald Trumpit

Për dekada me radhë, aksioni i Trumpit është udhëhequr nga tre urdhëresa brutale që, në rini, ia kishte diktuar mentori i tij, Roy Cohn: "Sulmo gjithmonë", "Mos prano kurrë gabimin", "Vetëshpallu gjithmonë fitues, edhe kur nuk është e vërtetë". Ishte një strategji e lindur në baret pranë gjykatave të Manhattanit dhe Brooklynit, për të mposhtur kundërshtarët me padi të ekzagjeruara, për t'u mbrojtur nga akuzat duke kundërsulmuar me veprime ligjore të njëpasnjëshme, për të frikësuar gjyqtarët. Metoda ekstreme që kanë funksionuar jo vetëm në botën pa skrupuj të ndërtuesve agresivë të pasurive të paluajtshme, por, vite më vonë, edhe në politikë, falë aftësisë mediatike të Trump për t'u shndërruar, për gati gjysmën e Amerikës, në një lloj fyelltari magjik.

Në mandatin e parë dhe në fillim të të dytit, Trumpi ndoqi të njëjtën linjë, duke shkaktuar

tronditje te vendet aleate të SHBA-së, të poshtëruara dhe të habitura, por edhe te kundërshtarët, sidomos Kina dhe Russia, të alarmuar nga paparashikueshmëria e tij. Por tashmë strategjia Cohn nuk funksionon më: një regjimi iranian, i bërë edhe më i egër pas goditjes së pjesshme të krerëve, dhe i bindur se nuk ka më asgjë për të humbur, i mjaftojnë disa varka të vogla, një grusht dronësh dhe disa raketa për të bllokuar Hormuzin.

## Gabime dhe "yes men"

Trump tashmë e di se ka bërë një gabim të madh duke ndezur këtë luftë: do të humbasë zgjedhjet dhe duhet të përballet me një zjarr politik në shtëpi, brenda partisë së tij dhe brenda vetë lëvizjes MAGA. Do të donte të dilte prej saj duke deklaruar se ka fituar, edhe nëse nuk është e vërtetë, por nuk mundet nëse Hormuzi mbetet i bllokuar dhe Teherani nuk dorëzon uraniumin e pasuruar. Pasdaranët e perceptojnë nxitimin e tij, kanë kuptuar se shpërthimet e natës presidenciale në rrjetet sociale ("Do t'ju kthej në epokën e gurit", "Hapeni atë ngushticë,

bastardë, do t'ju çoj në ferr") janë vetëm shprehje e frustrimit të një lideri që ka mbetur në kurth, edhe pse është njeriu më i fuqishëm në botë.

Ai po paguan pretendimin e tij për të fituar duke mbjellë frikë edhe te ata që nuk kanë më shumë për të humbur; po paguan mungesën e një strategjie, por edhe përqendrimin e tepruar të pushtetit: është rrethuar me yes men që nuk kanë guximin t'i tregojnë të vërtetën të pakëndshme, dhe nuk e paralajmërojnë kur hyn në një rrugë krejtësisht jorealiste.


## Precedenti

Që metoda e tij nuk do të funksiononte më, duhej ta kishte kuptuar tashmë një vit më parë, kur nisi ta aplikonte edhe te tarifatat doganore. Njeriu që nuk bën kurrë hapa pas, i gëlltiti të paktën dhjetë herë kërcënimet e tij ekstreme, duke shkaktuar tronditje në tregje (luhatje të qëllimshme, sipas disa interpretimeve dashakeqe). Ai pretendonte se ishte një metodë e mirë negociuese të godisje tavolinën me grusht, por kur mallrat kineze morën një

tarifë prej 10% në vend të 145% që kishte shpallur, Trumpit iu ngjit një nofkë poshtëruese: Taco, akronim për Trump Always Chickens Out – Trump tërhiqet gjithmonë.

I detyruar të tërhiqet përballë tregjeve, tani presidenti do të dalë i copëtuar nga një luftë ku, përveç rezistencës së papritur të regjimit, edhe më i militarizuar pas vrasjes së Udhëheqësit Suprem, nuk kishte kuptuar se dobësinë ushtarake amerikane në një konflikt asimetrik, dhe as atë ekonomike të vendit të tij: i ekspozuar ndaj krizave energjetike për shkak të çmimeve botërore, edhe pse teorikisht është i vetëmjaftueshëm për naftë dhe gaz. Trump dëshiron ta lërë pas Iranin dhe herët a vonë do t'ia dalë, por me një çmim të lartë. Nga pesë objektivat që kishte vendosur ditën e sulmit, denuklearizimi, ndryshimi i regjimit, çarmatimi i raketor, shkatërrimi i flotës, neutralizimi i aleatëve të jashtëm të Teheranit ( Hamas dhe Hezbollah), vetëm një është arritur: asgjësimi i flotës.

Pas talljes "Taco", tani Donald duhet të përballet me një fantazmë shumë më tinëzare: atë të Jimmy Carterit. / Corriere della Sera – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Beshiktashi kthen Asllanin tek Interi

Beshiktash, 7 muaj - Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Kristjan Asllani do të kthehet te skuadra e Interit në fund të sezonit aktual.

Beshiktashi ka vendosur që mos ta shfrytëzojë opsionin e blerjes

së Asllanit në verë, të cilin e kishte huazuar në fillim të këtij viti nga Interi. Asllani me fanellën e Beshiktashit ka regjistruar 15 ndeshje, ku ka shënuar 2 gola dhe ka bërë po aq asistime, por nuk ka bindur

drejtuesit e klubit turk për ta blerë kartonin e tij për 13 milionë euro. Mesfushori 24-vjeçar ka kontratë deri në vitin 2028 me Interin, ekip që menjëherë do ta nxjerrë në shitje pasi Asllani nuk bën pjesë

në planet e trajnerit Christian Chivu. Asllani në fillim të këtij sezoni është huazuar te Torino, ekip që ka vendosur ta shkëpusë kontratën e marrëveshjes me Interin në fillim të vitit.



## BESIM ALITI EMËROHET KRYESUES I KOMISIONIT KOORDINUES PËR FESTIVALIN OLIMPIK EVROPIAN

PRISHTINË, 7 MAJ - Sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Aliti është emëruar javë më parë kryesues i komisionit koordinues për Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF) Lignano Sabbiadoro 2027.

Aliti këtë javë ka qëndruar në Itali, për të vëzhguar procesin e punëve të tanishme për organizimin e ngjarjes më të madhe shumësportëshe për të

rinj në Evropë.

EYOF Lignano Sabbiadoro 2027 mbahen prej 24 korrik - 1 gusht 2027, ndërsa marrin pjesë 14 sporte të 48 shteteve. Është hera e parë në histori të sportit të Kosovës që një zyrtar emërohet kryesues i një komisionit për organizimin e një ngjarje shumë sportëshe ndërkombëtare.

Pikërisht kryesuesi i këtij komisioni, Aliti, është ftuar të jetë i pranishëm në Asamblenë Gjenerale të Komitetit Olimpik



të Evropës, për të raportuar për progresin e deritashëm të EYOF Lignano Sabbiadoro 2027. E veçanta e Asamblesë që mbahet më 12 dhe 13 qershor në Budapest të Hungarisë, është prania për herë të parë e presidentes së Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Kirsty Coventry.

Ky rol udhëheqës i sekretarit Aliti në një ngjarje kaq të rëndësishme si EYOF dëshmon besimin e Komitetit Olimpik të

Evropës ndaj kapaciteteve organizative dhe menaxheriale të kuadrove nga Kosova, duke e pozicionuar vendin gjithnjë e më fuqishëm në skenën ndërkombëtare të sportit. Aliti edhe më parë ka qenë pjesë e komisioneve koordinuese për organizimin e EYOF-ve ndërsa në Komitetin Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare është anëtar i komisionit koordinues të Lojërave Mesdhetare Taranto 2026.

## BASHKIMI TRIUMFON BINDSHËM NDAJ BORËS DHE SIGURON FINALEN E MADHE NË BASKETBOLL

Prizren, 7 maj - Bashkimi ka dhuruar një paraqitje dominante në ndeshjen vendimtare të serisë gjysmëfinale, duke mposhtur Borën me rezultat të thellë 100-76 dhe duke siguruar kalimin në finalen e ProCredit Superligës. Në duelin e pestë dhe vendimtar, pasi seria ishte e barabartë 2-2, prizrenasit treguan epërsi që nga fillimi i takimit dhe nuk e vunë



asnjëherë në dyshim fituesin. Me këtë triumf, Bashkimi ka fituar serinë 3-2 dhe avancoi në finale, ku do të përballlet me Trepçën. Skuadra vendase ishte shumë e shpërndarë në sulm, por janë dalluar disa individë me performancë të lartë. Më efikas për Bashkimin ishte Zeqiri me 23 pikë, i ndjekur nga Nwamu me 21 pikë dhe Shorter që ka shtuar 20

pikë. Kontribut të rëndësishëm dha edhe Lake me 14 pikë, ndërsa Bunjaku ka realizuar 6 pikë. Bashkimi ka kontrolluar ndeshjen në të katër periodat (19-23, 28-21, 28-19, 25-13), duke rritur gradualisht epërsinë dhe duke e mbyllur takimin me diferencë të thellë. Në anën tjetër, Bora nuk ka arritur të mbajë ritmin e kundërshtarit,

sidomos në pjesën e dytë të ndeshjes, ku diferenca është thelluar ndjeshëm. Me këtë fitore, Bashkimi tashmë kthen fokusin te finalja e madhe kundër Trepçës, në një përballje që pritet të jetë spektakolare për titullin kampion. Ndeshjet do të luhen të dielën dhe të mërkurën, saktësisht më datat 10, 13, 17, 20, 24, 27 dhe 31 maj.

## PSG-JA DHE ARSENALI NË HISTORI, FINALJA E LIGËS SË KAMPIONËVE LUHET MË 30 MAJ



PRISHTINË, 7 MAJ - Arsenali dhe Paris Saint-Germain do të përballen në finalen e Ligës së Kampionëve më 30 maj në Budapest, pasi kanë siguruar biletën për ndeshjen më të madhe të futbollit evropian. Parisienët kanë eliminuar Bayern Munichun në gjysmëfinale, ndërsa Arsenali ka triumfuar ndaj Atletico

Madrid për të siguruar finalen e madhe. Megjithatë, ajo që ka tërhequr vëmendje të madhe është ndryshimi i orarit të finales së këtij edicioni. Për herë të parë pas shumë vitesh, finalja nuk do të nisë në orën tradicionale 21:00, por në 18:00. Sipas UEFA, vendimi është marrë për të përmirësuar përvojën e tifozëve dhe për ta

bërë ndeshjen më të qasshme për audiencën ndërkombëtare dhe shikuesit më të rinj. "Finalja e Ligës së Kampionëve është kulmi i sezonit të futbollit dhe orari i ri do ta bëjë atë edhe më të arritshme, gjithëpërfshirëse dhe me më shumë ndikim për të gjithë", ka deklaruar presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin.

Sipas Ceferinit, një fillim më i hershëm i ndeshjes do t'u mundësojë tifozëve të shijojnë më shumë atmosferën dhe pjesën tjetër të mbrëmjes pas finales. Finalja do të zhvillohet në "Puskas Arena", stadium modern me kapacitet prej rreth 68 mijë spektatorësh, i cili konsiderohet një nga arenat më mbresëlënëse në Evropë.

## Mbappe luan në 'El Clasico', tifozët duan largimin e tij

MADRID, 7 - Sulmuesi Kylian Mbappe pritet të luajë për Real Madridin në ndeshjen "El Clasico" kundër Barcelonës, përkundër kritikave dhe peticionit të tifozëve madrilen për largimin e tij nga klubi.

Francezi nuk po kalon aspak periudhë të mirë në klub dhe mbetet të shihet nëse do të jetë startues apo në stol, të dielën mbrëma kundër Barçës. Mbappe i mungoi Realit në ndeshjen e fundit kampionale shkaku i

lëndimit, por të enjten ai është stërvitur me pjesën tjetër të ekipit. Situata e Mbappes te Reali mbetet e paqartë për shkak se tifozët e klubit nuk po e duan në klub për shkak të veprimeve të francezit.

Tashmë, mbi 30 milionë tifozë kanë firmosur peticionin, i cili bën thirrje për largimin e Mbappes nga skuadra e Real Madridit. Ai ka shënuar 41 gola këtë sezon, ndërsa ka kontratë valide me Realin deri në verë të vitit 2029.



### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gazeta Kosova e Re” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811517715 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gazeta Kosova e Re” D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811517715 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Gazeta Kosova e Re” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811517715 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shpendi Mirlina” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812413227 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Shpendi Mirlina” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812413227 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Shpendi Mirlina” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812413227 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Diellëzon Krasniqi nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Kongresi i Manastirit”, Damjan, nga klasa 1-5 dhe 6-9.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.
- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “FehmiAgani” Gjakovë me numër 200102037.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.



Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Uniteti" Sh.A.-Mitrovicë

Bazuar në dispozitat e nenit 21, nenit 25, par. 25.2, pika h, e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 31/2008 (dt. 15.06.2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/2021 (dt. 30.05.2012), dhe Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Auditimit të KRM "Uniteti". Sh.A – Mitrovicë, vendosi që të shpallë këtë:

#### SH PALLET KONKURS

**Pozita: Auditor i Brendshëm.**

**I përgjigjet: Komisionit të Auditimit.**

**Vendi: Mitrovicë.**

**Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.**

#### Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;
- Verifikimi i përshatshmërisë dhe funksionimit i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshatshmërisë dhe funksionimit i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlydhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit;
- Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;
  - Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëmitë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/apo Financave dhe Kontabilitetit;
  - Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm nga institucionet e licencuara në vend ose jashtë tij;
- Njohurit dhe shkathësitë profesionale
- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
  - Njohuri e Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;
  - Shkathësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
  - Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
  - Shkathësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;
  - Shkathësi kompjuterike në programet, Microsoft Word, Excel dhe Access;
  - Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

#### Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

1. Aplikacionin,
2. CV-në,
3. Diploma universitare duhet të vërtetohet tek noteri (nostrifikimi),
4. Deklarata nën betim;
5. Dëshminë për përvojën e punës,
6. Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
7. Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
8. Letër Motivimin,
9. Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj)- origjinale
10. Kopja e dokumentit të identifikimit.

#### Procedura e aplikimit

Dokumentacioni dorëzohet fizikisht në Sekretarinë e KRM "Uniteti" Sh.A – Mitrovicë, në zarf të mbyllur, me shënimin:

**Për pozitën: Auditor i Brendshëm i KRM "Uniteti" Sh.A – Mitrovicë.**

Konkursi do të jetë i hapur për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e shpalljes në gazetën "Epoka e Re". Dorëzimi i dokumenteve mund të bëhet brenda këtij afati kohor, duke filluar nga dita e publikimit të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit apo të pakompletuara nuk pranohen.



Prishtinë, 07.05.2026

#### NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812109454 me adresë: Rr. „Mazllam Kastrati, Tranziti i Vjetër“ pn, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 14.04.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panellet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.4363-2/25 dt. 18.08.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs.
- Njoftimin Nr. 04-353/01-21408 të dt. 07.03.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs.
- Aktvendimin nr. 04-353/01-135622 të dt. 10.10.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.04-353/01-22408 dt. 19.03.2026, për "Vendosjen e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 1 MW, ngastrata katastrale 00142-1 ZK Petrovë, gjegjësisht në objektin me nr. 24-0 ZK Petrovë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 4131 dt. 24.03.2026 të lëshuar nga KEDS SII.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektrike: [luan@ild-prizren.com](mailto:luan@ild-prizren.com), [crzen.krasniqi@solar2.eu](mailto:crzen.krasniqi@solar2.eu) dhe [LEGAL-LEECENSING@cro-ks.org](mailto:LEGAL-LEECENSING@cro-ks.org)

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

